

FJALA E DEPUTETES ETILDA GJONAJ

E HËNË 17 TETOR 2022

E nderuar zonja Ambasadore,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë,

Unë do të ndalem shumë shkurt në dy momente që kanë të bëjnë me pjesën e procesit ku jemi tashmë dhe më pas te një pikë që lidhet me pjesën përmbajtjesore të reformave kryesore që ne po zbatojmë.

Për sa i përket procesit të integritit, duhet thënë që ai nuk është thjesht një proces teknik, por është një proces politik, ku secila palë ka përgjegjësinë e saj, qoftë opozita, qoftë maxhoranca. Njëkohësisht, opozita ka jo vetëm të drejtën për të kërkuar nga qeveria, por ka edhe përgjegjësinë për t'u përfshirë në këtë proces, ashtu siç ne e kemi krijuar mundësinë në Kuvend nëpërmjet Komisionit të Integritit apo edhe Këshillit, i cili drejtohet nga opozita.

E dyta, edhe me ndryshimet që ne po përgatisim për sa i përket ligjit, për rolin e parlamentit, padyshim që aty opozita ka një zë dhe rol shumë të rëndësishëm. Në këtë aspekt, është mirë që të dyja palët dhe të gjithë aktorët, duke përfshirë edhe shoqërinë civile, të jenë të përfshirë në këtë proces, pasi nuk ka thjesht një autor, që është qeveria, por kërkon përfshirjen e të gjithë aktorëve, si politikë, ashtu edhe jashtë politikës.

E dyta, po për këtë proces, unë besoj se bashkëpunimi me ministren Dhuka dhe ministren Xhaçka në aspektin e përfaqësimit apo përgjegjësisë politike do të jetë maksimal për sa kohë që i gjithë qëllimi edhe i Komisionit të Integritit është për nxitjen dhe rritjen e shpejtësisë së këtij procesi që Shqipëria po kalon. Patjetër që do të marrë kohën e tij, ka fazat e tij, por besoj se të gjitha reformat, që deri tani kanë sjellë rezultate shumë pozitive, të cilat janë ritheksuar edhe në progres-raport, i japin mundësinë vendit dhe të gjithëve ne që të kemi çfarë të vendosim dhe ndjekim për sa i përket zbatueshmërisë dhe rezultateve që arrihen në fazat e mëvonshme.

Dua të flas edhe një moment për pjesën e reformës në drejtësi. Raporti e ka shumë të qartë që reforma në drejtësi mbetet një pikë e fortë për ecurinë e Shqipërisë në procesin e integritit europian, por

njëkohësisht ka treguar një progres shumë të mirë me çfarë ka arritur të paktën për këtë vit. Si plotësimi i Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese me anëtarë, (ambasadorja përmendi Back Lock-un, ashtu si edhe në raport), por njëkohësisht edhe ecuria e procesit të vetingut janë rezultate të pamundura të mohohen apo neglizhohen.

Patjetër që ka elemente dhe momente ku duhet vendosur më shumë theksi dhe fokusi, siç janë rastet e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilët kanë denoncime për korrupsion që duhen çuar nga institucioni i vetingut në organet e prokurorisë, apo siç është edhe sistemi i menaxhimit të çështjeve dhe institucionet përkatëse e kanë në fokusin kryesor për të arritur rezultatin sa më shpejt të jetë e mundur.

Unë besoj se ne flasim për një reformë në drejtësi që ka krijuar një sistem me vlera profesionale dhe vlera me integritet dhe nuk flasim për emra të përveçëm, të cilët kanë pasur shansin, ashtu si edhe ne, të kontribuojnë për hartimin e reformës në drejtësi dhe më pas mund të jenë përfshirë në institucionet e reja të drejtësisë, por po flasim për emra të nderuar, njerëz me integritet, që kanë qenë pjesë e sistemit të drejtësisë, kanë qenë magjistratë apo kanë qenë pjesë e trupës akademike në fakultetet e drejtësisë dhe Shkollën e Magjistraturës.

Prandaj, unë besoj se përpara se të flasim me emra, është më mirë të flasim për atë sistem që është ndërtuar mbi bazën e vlerave, të cilat është shumë e vështirë të thuash që ndryshuan në një ditë, sepse, në fund të fundit, kemi të bëjmë me një mentalitet. E rëndësishme është që sistemi është aty. Institucionet e reja të drejtësisë do të bëjnë të pamundurën që ky sistem të vlerash të përkthehet më pas edhe në rezultatet që shqiptarët t'i kenë të prekshme në mënyrë të përditshme. Faleminderit!